



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



THIRRJE PËR APLIKIM

Drejtoria për Bujqësi

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës se mund të aplikojnë për t'u certifikuar si prodhues organik

Kriteret e përgjithshme:

- Certifikimi do të përfshijë fermerët, grupet e fermerëve si edhe qendrat për grumbullim dhe përpunim të prodhimeve organike,
- Fermerët, grupet e fermerëve duhet të jenë banorë të Komunës së Prishtinës dhe pronën ta kenë në territorin e Komunës së Prishtinës,
- Qendrat grumbulluese-përpunuese për prodhimet organike veprimtarinë duhet ta zhvillojnë në territorin e Komunës së Prishtinës, si edhe personi i autorizuar juridik duhet të jetë banor i Komunës së Prishtinës,
- Pagesat për shërbimet e kryera duhet të bëhen përmes bankës dhe ate në dy faza varësisht prej aktiviteteve të realizuara,
- Rimbursimi i mjeteve nga ana e Komunës së Prishtinës bëhet për fermerët pasi që të ofrohen dëshmitë për kryerjen e shërbimeve

Kriteret specifike:

1.Auditimi dhe certifikimi i fermerëve individual për prodhues të kulturave të ndryshme bujqësore në sipërfaqe të parcelave prej 0,2-2,0 ha,

- Vlera e përkrahjes nga ana e Komunës së Prishtinës për certifikim individual është deri 720.00 Euro,

2.Auditimi dhe certifikimi grupor i fermerëve për prodhues të kulturave të ndryshme bujqësore në sipërfaqe të parcelave deri 20 ha,

- Vlera e përkrahjes nga ana e Komunës së Prishtinës për certifikim grupor është deri 510.00 Euro/fermer(10 fermer x 510.00 Euro= 5,100.00 Euro),ndërsa vlera e përkrahjes për lëshimin e Certifikatës është deri në 720.00 Euro /grup të fermerëve,

3.Auditimi dhe certifikimi për prodhues dhe përpunues të produkteve përfshirë vjeljen, tharjen apo ngrirjen apo çdo formë tjetër përpunimi si edhe ruajtjen dhe shitjen të të gjitha kulturave bujqësore në parcelat deri në 2 ha,

- Vlera e përkrahjes nga ana e Komunës së Prishtinës është deri 1,070.00 Euro .

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin i llogarisë bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme me afat deri në një vit;
- Kopja e Planit;
- Licenca për entitetin juridik-qendra grumbulluese përpunuese;
- Fatura dhe konfirmimi i transaksionit bankar për shërbimet e kryera;
- Numri i regjistrimit të fermerit(NIF).

Data e aplikimit prej 15.05.2018 deri më 04.06.2018